



PËR TË NJËZETËN HERË DËSHTON KONSTITUIMI I KUVENDIT



Ka dështuar sërish konstituimi i Kuvendit të Kosovës, duke shënuar dështimin e njëzetë me radhë. Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, ka kërkuar nga subjektet politike të propozojnë nga një përfaqësues për Komisionin Zgjedhor, por as

kësaj radhe nuk kaloi propozimi. Seanca u ndërpre, por do të vazhdojë pas 48-orësh. Mbi 60 organizata të shoqërisë civile u kanë bënë thirrje partive të arrijnë një marrëveshje që i jep fund bllokadës. Ato thanë se kriza

institucionale me bllokimin e konstituimit të Kuvendit "ka kaluar çdo kufi të tolerueshëm dhe po dëmton jo vetëm Kuvendin, por edhe funksionimin e gjithë sistemit demokratik dhe institucional të vendit"

**KURTI I THOTË
KALLASIT SE
KOSOVËS DUHET
T'I JEPET STATUSI
I VENDIT KANDIDAT
PËR NË BE** F. 3



**BLOKADA NË
KUVEND, KOMF-i:
KARRIGET TUAJA NUK
VLEJNË MË SHUMË SE
JETA DHE MIRËQENIA
E FËMIJËVE** F. 6



**VENDET E G7-S PAJTOHEN PËR
RRITJE TRYSNIE NDAJ RUSISË, NËSE
S'KA ARMËPUSHIM NË UKRAINË** F. 2

**ISH-KONGRESISTI AMERIKAN U
SHKRUAN LETËR LIDERËVE TË
UÇK-SË NË HAGË: MBAHUNI TË
FORTË. MENDOJ SHPESH PËR JU** F. 5

**KALLASI NË VERI: E RËNDËSISHME TË
DËSHMOJMË VETË SE ÇFARË PO
NDODH NË TERREN** F. 6


EKONOMI



**DEFICITI TREGTAR I KOSOVËS
NË MUAJIN PRILL ARRITI
NË 15,2 PËR QIND** F. 8

**ZRRE THOTË SE LIBERALIZIMI I
TREGUT PËR ENERGJI NIS MË 1
QERSHOR** F. 8

SPORT



**PRISHTINA FITON KUPËN E KOSOVËS,
SIGURON DALJEN NË EVROPË** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vendet e G7-s pajtohen për rritje trysnie ndaj Rusisë nëse s’ka armëpushim në Ukrainë

OTAVA, 23 MAJ - Ministrat e Financave dhe guvernatorët e bankave qendrore të vendeve të G7-s [grupi i shtatë shteteve më të industrializuara të botës] janë pajtuar gjatë një takimi në Kanadanë përëndimore se Rusia mund të përballet me sanksione shtesë nëse ajo i reziston një nisme për një armëpushim në luftën e saj në Ukrainë. Shefat e Financave të G7-s kanë dënuar “luftën brutale” të Rusisë nëpërmjet një komunikate më 22 maj, në fund të takimit të tyre, dhe kanë thënë se nëse përpjekjet për të arritur një armëpushim dështojnë, ata do t’i shqyrtojnë të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë “një shtim të mëtejshëm të sanksioneve”. Komunikata ka thënë, po ashtu, se asetet sovranë të Rusisë, që mbahen në juridiksionet e vendeve të G7-s, do të mbeten të ngjira derisa Moskë t’i japë fund

luftës dhe të paguajë për dëmet që ia ka shkaktuar Ukrainës. Ministrat janë zotuar edhe që të punojnë bashkë që të sigurojnë se asnjë vend apo entitet që financojnë apo furnizon “makinerinë ruse të luftës” nuk do të mund përfitojnë nga rindërtimi i Ukrainës. “Ky është një qëndrim shumë i fortë”, ka thënë ministri kanadez i Financave, Francois-Philippe Champagne, duke e quajtur një shtyllë thelbësore të komunikatës, e cila nuk ka përmendur Kinën apo vendet e tjera që akuzohen se e furnizojnë Rusinë me komponentë kritikë. Takimi i ministrave në Malet Shkëmbore Kanadeze i ka paraprirë një samiti të G7-s që do të mbahet në mes të qershorit, në një resort të afërt malor. Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, do të marrë pjesë në këtë samit, ka konfirmuar Shtëpia e Bardhë më



22 maj. Në takim mori pjesë edhe ministri ukrainas i Financave, Serhiy Marchenko, i cili i bëri thirrje G7-s ta vazhdojë trysinë ndaj Rusisë. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky nuk e ka përmendur takimin e G7-s në videoadresimin e tij në mbrëmje, por ka thënë se Ukraina është e gatshme t’i

ndërmarrë “hapat më të shpejtë të mundshëm” për t’i dhënë fund luftës. “Ukraina nuk është e interesuar ta zgjasë luftën, por të përgatitet për çfarëdo zhvillimi. Është e qartë për botën se është faji i Rusisë që lufta ende po vazhdon”, ka thënë ai. “Ne të gjithë, nga ana jonë, po i bëjmë të gjitha punët e nevojshme

përgatitore. Ajo që nevojitet është gatishmëri reciproke nga Rusia - dhe ajo nuk ekziston tani”. Përpjekjet diplomatike për t’i dhënë fund konfliktit janë përshpejtuar, ndërsa zyrtarët rusë dhe ukrainas javën e kaluar kanë zhvilluar bisedimet e tyre të para të drejtpërdrejta pas më shumë se tre vjetësh. Por, Kremlini ka thënë më 22 maj se “ende nuk ka pajtim” për bisedimet e reja për paqe me Ukrainën, duke hedhur poshtë raportimet se dy vendet do të zhvillojnë së shpejti negociata në Vatikan. Trumpi ka biseduar përmes telefonit me presidentin rus Vladimir Putin më 19 maj, në një përpjekje për t’i dhënë fund, siç është shprehur ai, “kasaphanës” - por as telefonata e as bisedimet e mëhershme të drejtpërdrejta nuk e shtynë Rusinë të bëjë lëshime.

Ukraina dhe Rusia shkëmbejnë një numër të madh të burgosurish



KIEV, 23 MAJ - Një shkëmbim i madh i të burgosurve midis Ukrainës dhe Rusisë është duke u zhvilluar të premtën, mëson “Radio Evropa e Lirë” nga një burim i saj ukrainas. Burimi, i cili nuk ishte i autorizuar të fliste publikisht, foli në kushte anonimiteti pasi presidenti amerikan Donald Trump deklaroi se Ukraina dhe Rusia sapo kishin përfunduar një shkëmbim të madh të të burgosurve. Palët kishin bërë përgatitje për këtë shkëmbim që nga bisedimet për paqe në Stamboll javën e kaluar, sipas tij. “Një shkëmbim i

madh i të burgosurve sapo ka përfunduar midis Rusisë dhe Ukrainës. Do të hyjë në fuqi së shpejti”, shkroi Trump në platformën “Truth Social” të premtën. Të enjten presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se marrëveshja për një shkëmbim të burgosurish “1 000 për 1 000” ishte “ndoshta rezultati i vetëm real” i një takimi 90-minutësh në Stamboll më 16 maj. Ai ishte takimi i parë i drejtpërdrejtë për paqe midis zyrtarëve ukrainas dhe rusë që nga fillimi i pushtimit të potë të Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022.

Zelensky tha se palët kanë shkëmbyer lista të të burgosurve që mund të përfshiheshin në marrëveshje. Ministri i Mbrojtjes, Rustem Umerov, ka deklaruar se institucionet “kyçe” të Ukrainës kanë punuar për zbatimin e planit hap pas hapi për shkëmbimin e të burgosurve. Rusia nuk i ka pranuar thirrjet nga Ukraina, Shtetet e Bashkuara dhe vendet evropiane për një armëpushim 30-ditor dhe nuk është caktuar asnjë takim i ri. Rusia dhe Ukraina kanë kryer disa shkëmbime të të burgosurve që nga fillimi i pushtimit.

Kriza e migracionit dhe tensionet me Gjykatën Evropiane, Italia dhe Danimarka bashkohen me shtetet skeptike

ROMË, 23 MAJ - Italia, Danimarka dhe shtatë vende të tjera evropiane Austria, Belgjika, Republika Çeke, Polonia dhe vendet baltike, janë bashkuar në një letër të përbashkët ku shprehin kundërshtimin ndaj interpretimit aktual të Konventës për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, veçanërisht për çështjet që lidhen me migracionin. Në letër, vendet theksojnë nevojën për një debat të ri rreth mënyrës se si po zbatohen të drejtat, duke vënë në dukje se “ajo që dikur ishte e drejtë, mund të mos jetë zgjidhja nesër”. Ata theksuan se migracioni i

parregullt ka qenë një problem serioz për Evropën gjatë dekadave të fundit, por shtuan se shumë prej emigrantëve kanë ardhur përmes rrugëve ligjore, janë integruar në shoqëri, kanë mësuar gjuhët dhe kontribuojnë në vendet pritëse. Nga ana tjetër, u theksua se disa emigrantë kanë zgjedhur të mos integrohen dhe madje janë përfshirë në veprimtari kriminale, duke rrezikuar kështu besimin dhe stabilitetin social të vendeve pritëse. Në një pasazh të ashpër, letra kritikonte interpretimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për kufizimin e lirisë së shteteve për të marrë vendime

politike mbi migracionin, duke vënë në rrezik mbrojtjen e shoqërive demokratike dhe popullatave të tyre. Udhëheqësit e këtyre vendeve u shprehën se qëndrojnë “në linjë me shumicën e qytetarëve evropianë” dhe synojnë ta “rivendosin ekuilibrin e duhur” në këtë çështje. Ky reagim vjen në një kohë kur migracioni mbetet një temë kyçe dhe e nxehtë në zgjedhjet në Evropë, ku qytetarët shprehin gjithnjë e më shumë pakënaqësi ndaj mungesës së veprimeve të qarta për t’i adresuar problemet migratore. Situata e Gjermanisë dhe Polonisë është shembull i qartë i këtij trendi.



CILAT PREJ MASAVE NDËSHKUESE KA FILLUAR BE-JA T'IA HEQË KOSOVËS?

PRISHTINË, 23 MAJ - Bashkimi Evropian më në fund ka nisur t'ia heqë dalëngadalë masat Kosovës, pas gati dy vjetësh, por me kusht që ajo t'i ulë tensionet në veriun e vendit të banuar me shumicë serbe, kështu paralajmëroi në Prishtinë shëfja e diplomacisë së BE-së, Kaja Kallas.

Derisa Kallasi nuk shpjegoi se kur ka filluar heqja e masave dhe çfarë masash mund të jenë hequr deri tani, "Radio Evropa e Lirë" mëson nga burime të saj në Bruksel se masat që janë hequr kanë të bëjnë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA), paktit të parë kontraktual ndërmjet Kosovës dhe bllokut evropian, dhe Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor.

Sipas burimeve, tani ka filluar puna e disa nënkomiteteve të MSA-s si dhe ofrimi i ndihmës teknike në kuadër të Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor.

Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor është iniciativë e përbashkët e BE-së, institucioneve financiare dhe donatorëve, që synon zhvillimin socio-ekonomik dhe të perspektivës evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Kosova mbështetet nga ky mekanizëm që nga viti 2009. Deri në vitin 2021 në Kosovë ishin mbështetur 30 projekte në vlerë prej 1.8 miliard eurosh nga ky mekanizëm. Projektet



përfshijnë ndërtimin e rrugëve, rehabilitimin e hekurudhave, sistemet e ngrohjes qendrore dhe përmirësimin e sistemit të ujërave të zeza.

Për vitet 2023-2030, në kuadër të këtij mekanizmi, në Kosovë janë paraparë edhe projekte të tjera, si: Autostrada e Paqes Prishtinë - Nish, rruga hekurudhore Beograd - Prishtinë, ngrohja diellore për Prishtinën, impianti për trajtimin e ujërave të zeza për Prishtinën e të tjera.

Këto masa filluan të hiqen nga Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të BE-së (EEAS) dhe Komisioni Evropian pas diskutimeve në Këshillin e Punëve të Jashtme në prill, thotë burimi. "Vendimi

vjen pas zhvillimit paqësor të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë në fillim të këtij viti. Siç tha përfaqësuesja e lartë [Kallas], ky proces është gradual dhe i kushtëzuar me përparim të vazhdueshëm drejt shtensionimit", thekson burimi.

EEAS dhe Komisioni tani po e zbatojnë këtë vendim, duke i mbajtur të informuara shtetet anëtare. Baza për këtë vendim ishin konkluzionet e Këshillit të BE-së nga dhjetori 2024, sipas të cilave, BE-ja do të ishte e gatshme ta fillonte heqjen graduale të masave, paralelisht me hapat e shtensionimit në veri të Kosovës, sipas burimit. Kallasi paralajmëroi gjatë

vizitës së saj në Prishtinë, se derisa ky vendim hap derën për mundësi më të mëdha për zhvillimin e Kosovës edhe për lidhje më të ngushta me Evropën, ai varet nga ulja e tensioneve në veri.

BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës më 2023 - pas rritjes së tensioneve në veri të vendit.

Kallasi tha se mbyllja e institucioneve paralele serbe në veri të Kosovës nga autoritetet e Kosovës "po minon" përpjekjet drejt shtensionimit të situatës. Autoritetet e Kosovës i kanë mbyllur një sërë institucionesh paralele serbe në javët e fundit, për të cilat thonë se janë të jashtëligjshme.

Cilat janë masat e BE-së ndaj Kosovës?

Masat e BE-së ndaj Kosovës përfshinin: suspendimin e përkohshëm të grupeve punuese për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave bilaterale. Gjithashtu, u suspendua edhe programimi i fondeve për Kosovën, të cilat ishin paraparë të dorëzoheshin përmes Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor dhe IPA 2024 (Instrumentet e Para-Anëtarësimit).

Programi IPA, sipas Komisionit Evropian, është paraparë si "mënyrë përmes së cilës BE-ja përkrah reforma në 'vendet në procesin e zgjerimit' me ndihmë financiare dhe teknike". Kosova ka përfituar gjithsej 1.21 miliard euro nga ky program që nga viti 2007 deri në fund të vitit 2022.

E nga programi Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor, Kosova ka përfituar rreth 1.8 miliard euro nga viti 2009 deri më 2021. Por, pas masave ndëshkuese, Kosova mbeti jashtë granteve që BE-ja miratoi në korrik të vitit 2023 në vlerë prej 2.1 miliard eurosh.

KURTI I THOTË KALLASIT SE KOSOVËS DUHET T'I JEPET STATUSI I VENDIT KANDIDAT PËR NË BE

PRISHTINË, 23 MAJ - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka takuar në një darkë pune përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Kaja Kallas. Duke i uruar mirëseardhje në Prishtinë, kryeministri Kurti e falënderoi për vizitën dhe mbështetjen e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës.

Diskutuan për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe BE-së, agjendën e reformave evropiane dhe planin e rritjes. Kryeministri theksoi se vendi ynë, krahas linjësimit të politikës së jashtme me atë të Bashkimit Evropian, ka bërë përparim të konsiderueshëm në reforma të brendshme dhe se kjo evidentohet dhe dëshmohet edhe në raportet e vendit të BE-së.

Kryeministri e falënderoi Kallasin për njoftimin se BE-ja



ka nisur largimin gradual të masave kufizuese ndaj Kosovës dhe përpjekjet e saj në këtë drejtim, teksa shtoi se

ato duhet të hiqen plotësisht dhe theksoi që Kosova duhet ta marrë statusin kandidat si demokracia më e avancuar e

Ballkanit Perëndimor. Gjatë darkës së shtruar nga kryeministri, gjithashtu u diskutua edhe për procesin

paszgjedhor në vend dhe angazhimet për formimin e institucioneve të legjislaturës së nëntë.

Në lidhje me procesin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, kryeministri theksoi rëndësinë e zbatimit të plotë të Marrëveshjes Bazike dhe Aneksit të saj.

Ndërkohë që rikujtoi se Serbia duhet të mbahet përgjegjëse për sulmin terrorist dhe paramilitar në Banjskë dhe se kryeterroristi Millan Radoičiq, për të cilin tashmë ka aktakuzë 160 faqesh nga Prokuroria e Republikës së Kosovës, duhet t'i dorëzohet Kosovës.

Kryeministri Kurti, gjithashtu, ngriti çështjen e shkeljeve të vazhdueshme dhe të rënda të të drejtave të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc nga shteti i Serbisë dhe kërkoi që BE të bëjë veprime konkrete për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve të luginës.



PËR TË NJËZETËN HERË DËSHTON KONSTITUIMI I KUVENDIT

Ka dështuar sërish konstituimi i Kuvendit të Kosovës, duke shënuar dështimin e njëzetë me radhë. Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, ka kërkuar nga subjektet politike të propozojnë nga një përfaqësues për Komisionin Zgjedhor, por as kësaj radhe nuk kaloi propozimi. Seanca u ndërpre, por do të vazhdojë pas 48-orësh. Mbi 60 organizata të shoqërisë civile u kanë bënë thirrje partive të arrijnë një marrëveshje që i jep fund bllokadës. Ato thanë se kriza institucionale me bllokimin e konstituimit të Kuvendit “ka kaluar çdo kufi të tolerueshëm dhe po dëmton jo vetëm Kuvendin, por edhe funksionimin e gjithë sistemit demokratik dhe institucional të vendit”

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 23 MAJ - Për të njëzetën herë me radhë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar të premten ta konstituojnë përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. As thirrja e kryediplomates së Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, e cila vizitoi Prishtinën për herë të parë të enjten, që partitë parlamentare të bashkëpunojnë për ta zhbllokuar ngërçin politik në vend, nuk solli ndryshim.

Më 23 maj ligjbërësit refuzuan për të dymbëdhjetën herë rresht ta formonin një komision për mbikëqyrjen e një votimi të fshehtë për kreun e ri të organit ligjvënës.

Çështja e votimit të fshehtë, që u propozua më 1 maj nga kryesuesi i seancës, Avni Dehari, pasi e propozuara e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk arriti në disa votime t'i merrte 61

votat e nevojshme për t'u konfirmuar në post, është dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë.

Ato thonë se është jokushtetuese mënyra se si LV-ja po tenton që kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshehtë, dhe i kanë kërkuar Kushtetueses të marrë “një masë të përkohshme për ndalim të mbajtjes së seancave, derisa me prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe ta marrë një vendim”.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe refuzuan sërish, në vazhdimin e seancës konstituive të premten, që ta propozonin një përfaqësues që do ta siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshehtë. Seanca konstituive do të vazhdojë të dielën e 25 majit.

Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e

Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve. Procesi ka ngecur te pika e tretë: zgjedhja e kryeparlamentarit.

Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se Kuvendi po mbetet peng i kryeneçësisë së Albin Kurtit. Çitaku para medieve tha se Kosova ka humbur 103 ditë nga zgjedhjet e 9 shkurtit. “Sot kanë kaluar 103 ditë nga 9 shkurti. Janë 103 ditë të humbura për Kosovën. Kuvendi vazhdon të mos jetë i konstituuar. Kosova po mbetet peng e kryeneçësisë së Albin Kurtit”, tha Çitaku.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka shprehur qëndrimin e partisë së tij lidhur me përkrahjen për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, duke theksuar gatishmërinë për të votuar një kandidat unifikues. Haradinaj para fillimit të tentimit të njëzetë të konstituimit të Kuvendit u shpreh se do ta votonin për kryeparlamentar edhe Glauk Konjufcën. “Mbaj shpresë se do të propozohet një kandidat unifikues, edhe pse nuk është përgjegjësi e jona. Por, prapë do ta japim votën për një kandidat unifikues, si Bogujevci dhe Selimi, por do të mund ta votojmë edhe Glauk Konjufcën”, ka thënë Haradinaj.

Organizatave të shoqërisë civile u bëjnë thirrje partive t'i japin fund bllokadës

Mbi 60 organizata të shoqërisë civile u kanë bërë thirrje partive të arrijnë një marrëveshje që i jep

fund bllokadës. Ato thanë se kriza institucionale me bllokimin e konstituimit të Kuvendit “ka kaluar çdo kufi të tolerueshëm dhe po dëmton jo vetëm Kuvendin, por edhe funksionimin e gjithë sistemit demokratik dhe institucional të vendit”. “Ne, organizatat e poshtëshënuara të shoqërisë civile, të angazhuara me përkushtim në mbrojtjen e demokracisë dhe funksionimit të shtetit të së drejtës, po e përcjellim me shqetësim të thellë dështimin e vazhdueshëm të deputetëve dhe deputeteve për të konstituuar Kuvendin e Republikës së Kosovës, si dhe refuzimin e udhëheqësve të partive politike për të bashkëpunuar dhe për të hyrë në dialog me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje që do t'i jepte fund kësaj krize institucionale. Kriza institucionale që pasoi zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 ka kaluar çdo kufi të tolerueshëm dhe po dëmton jo vetëm Kuvendin, por edhe funksionimin e gjithë sistemit demokratik dhe institucional të vendit. Qeveria aktuale, të cilës i ka përfunduar mandati, po vazhdon të veprojë pa mbikëqyrje dhe kontroll parlamentar, situatë kjo e papranueshme për një shtet demokratik”, është thënë në reagimin e këtyre organizatave të shoqërisë civile.

Ndër të tjera, thuhet se Kuvendi jofunksional po e pamundëson miratimin e ligjeve të rëndësishme dhe vendimeve strategjike që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe qytetareve, duke rrezikuar stabilitetin institucional, zhvillimin ekonomik dhe besimin

qytetar në përfaqësim demokratik. “Blokada aktuale është duke vonuar e rrezikuar pranimin e fondeve nga Plani i Rritjes së BE-së, në kohën kur masat e vendosura nga BE dhe pezullimi pothuajse i tërësishtëm i fondeve amerikane kanë reduktuar ndjeshëm mbështetjen financiare për Kosovën. Zhvillimet gjeopolitike aktuale kërkojnë përgjegjësi dhe veprime të shpejta nga shtetet demokratike. Mosfunksionalizimi i Kuvendit të Kosovës është i papërgjegjshëm dhe i dëmshëm. Ky stagnim rrezikon që vendet partnere të humbin besimin në aftësinë tonë për të ndërtuar institucione funksionale dhe për të vepruar si një shtet serioz në skenën ndërkombëtare. U bëjmë thirrje udhëheqësve të partive parlamentare që të marrin përgjegjësinë që u është besuar dhe të veprojnë menjëherë për tejkalimin e krizës politike. Përmes dialogut dhe me fokus te zhvillimi i vendit dhe mirëqenia e qytetarëve, të arrijnë një marrëveshje që i jep fund bllokadës. Mungesa e vullnetit për bashkëpunim dhe përqendrim në interesin e përbashkët është e papranueshme dhe cenon thellë besimin publik në përfaqësimin demokratik”, thuhet në këtë reagim.

Sipas organizatave të shoqërisë civile, mosveprimi nuk është opion. “Çdo vonesë e mëtejme kërkon llogaridhënie publike. Shoqëria civile mbetet e gatshme të ofrojë kontributin e saj për tejkalimin e kësaj krize dhe rikthimin e funksionalitetit demokratik në vend”, është thënë në këtë reagim.

ISH-KONGRESISTI AMERIKAN U SHKRUAN LETËR LIDERËVE TË UÇK-SË NË HAGË: MBAHUNI TË FORTË. MENDOJ SHPESH PËR JU

PRISHTINË, 23 MAJ - Ish-kongresisti dhe ish-ambasadori amerikan Tony Hall ka njoftuar se ka udhëtuar në Hagë. Në mungesë të vizitës brenda Qendrës së Paraburgimit të Gjykatës Speciale, Hall u ka shkruar një letër liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Në këtë letër ai ka thënë se kishte dëshirë t'i takonte liderët e UÇK-së, por se nuk ka mundur ta bëjë një gjë të tillë. Në këtë kontekst, Hall ka thënë se mendon shpesh për Thaçin, Veselin, Krasniqin, Selimin dhe familjet e tyre. "Mendoj shpesh për ju dhe lutem rregullisht për ju, familjet tuaja dhe për Kosovën. Edhe pse gjatë kësaj vizite nuk arritëm të takoheshim personalisht, ta dini se ju nuk jeni harruar", ka shkruar ai në letrën të cilën ua ka dërguar liderëve të UÇK-së. Po ashtu, ish-kongresisti Hall ka



Tony P. Hall
United States Ambassador
United States Congressman, Retired

Hashim Thaci
Kadri Veseli
Jakup Krasniqi
Rexhep Selimi

May 19, 2025

My dear friends,

It was my earnest desire to meet with you in person this week to encourage our mutual faith, our hope for reconciliation, and to grow in our respect for one another and especially for your country of Kosovo. Despite not being able to see you face to face, I am not deterred in coming and will be with you in person this Friday, but only a few dozen meters away from you, just outside the prison walls. We will be sharing the same soil and same air and it is in that spirit that I want to also give you some thoughts from the scriptures so that we may still offer you some encouragement in our coming.

First, I want to say how grateful I am for your friendship. I think of you often and pray regularly for you, your families and for Kosovo. While on this visit we may not see each other in person, you are not forgotten. Personally, I have found great encouragement from the instruction in scripture that "We do not fix our eyes on what is seen, but on what is unseen, for what is seen is temporary, and what is unseen is eternal." Therefore, do not be discouraged that I cannot sit alongside you, for I am with you, just outside these walls! I come with friends who I wished to introduce to you, as our fellowship is growing, despite the constraints of men! This is one of the great strengths of our faith, so be strong and courageous.

Second, remember that although you may be hidden away, your real strength is in the Lord. When I think of your situation, I remember the strength my friends and I experienced when we worked for reconciliation in the Holy Land. We trusted that "God has not given us a spirit of timidity but of power and love and self-control... and by the Holy Spirit, who dwells within us, guard the good deposit entrusted to you." We pray the same for you, that the work which was started in Kosovo will bear good fruit.

You are remembered by many friends as we stand outside the walls saying your names and praying that much good will still prosper in you and in Kosovo. While you may be imprisoned, you are not prevented from still doing good. You, my friends, have much yet to do, and can do great things for your families and country.

Finally, as we pray for you today, I want to encourage you to call on your fellow Kosovars to also pray with you and for your country. When I was in Congress, I led an effort to recognize the first Thursday in May as the National Day of Prayer which President Reagan signed into law. This past year I was invited to Ukraine to visit with their parliament about creating a similar national day of prayer in their country. They passed that law four months ago, and now the U.S. and Ukraine are the only two countries with a national day of prayer. I believe when a nation humbles themselves in prayer, God listens. Imagine what might happen if together you would call on your countrymen into a day of prayer for your nation.

Thank you, dear brothers, for receiving my letter, and for the hospitality of your families who welcomed me to Kosovo. I stand here with friends that I have brought from my country and from Kosovo to pray with you and for you. Be strong and courageous, you still have much to do and you have the spiritual means to do it.

In the name of Jesus
Your brother and friend,

Tony Hall

kërkuar nga liderët e UÇK-së të qëndrojnë të fortë. "Mbahuni të fortë dhe të guximshëm. Keni ende shumë për të bërë dhe keni mjetet shpirtërore për ta bërë këtë", ka shkruar ai.

Letra e plotë:

Hashim Thaçi
Kadri Veseli
Jakup Krasniqi
Rexhep Selimi

19 maj 2025, Hagë

Miqtë e mi të dashur, Ishte dëshira ime e zjarhtë të takohesha me ju personalisht këtë javë për të inkurajuar besimin tonë të ndërsjellë, shpresën tonë për pajtim dhe për të rritur respektin tonë për njëri-tjetrin dhe veçanërisht për vendin tuaj - Kosovën. Pavarësisht se nuk munda t'ju takoj personalisht, nuk jam i dekurajuar të vij ke ju dhe do të jem atje me ju, vetëm disa dhjetëra metra larg jush, aty jashtë mureve të burgut ku ju po mbaheni. Dhe kështu së bashku me ju, do të ndajmë të njëjtën tokë dhe të njëjtin ajër dhe në këtë frymë që dua t'ju jap ca citime e mendime nga shkrimet e shenjta. Dhe, në këtë mënyrë shpresojmë t'ju ofrojmë ca kurojo dhe inkurajim me vizitën tonë. Së pari, dua të them sa mirënjohës jam për miqësinë tuaj. Mendoj shpesh për ju dhe lutem rregullisht për ju, familjet tuaja dhe për Kosovën. Edhe pse gjatë kësaj vizite nuk arritëm të takoheshim personalisht, ta dini se ju nuk

jeni harruar. Unë kam gjetur inkurajim të madh nga udhëzimi në shkrimet e shenjta se "Ne nuk i fiksojmë sytë tek ajo që shihet, por tek ajo që nuk shihet, sepse ajo që shihet është e përkohshme dhe ajo që nuk shihet është e përjetshme".

Prandaj, mos u dekurajoni nga fakti se nuk munda të ulem sot së bashku me ju, sepse unë jam me ju, pikërisht jashtë këtyre mureve! Vij edhe me miq tjerë që doja t'ju prezantoja, sepse shoqëria jonë po rritet, pavarësisht kufizimeve që kanë vënë ca njerëz! Kjo është një nga pikat e forta të besimit tonë, prandaj mbahuni të fortë dhe të guximshëm.

Së dyti, mos harroni se, edhe pse mund të jeni të mbyllur atje, forca juaj e vërtetë është te Zoti. Kur mendoj për situatën tuaj, më kujtohet forca që unë dhe miqtë e mi përjetuam kur punuam për pajtim në Tokën e Shenjtë. Ne besuam se "Zoti nuk na ka dhënë një frymë frike, por fuqie, dashurie dhe vetëkontrolli... dhe me anë të Frymës së Shenjtë, që banon brenda nesh, ruajeni amanetin e shenjtë që ju është besuar". Ne lutemi të njëjtën gjë për ju, që puna që filloi në Kosovë të japë fryte të mira.

Ta dini se, derisa ne po qëndrojmë jashtë këtyre mureve duke përmendur emrat tuaj dhe duke u lutur që të mira të shumta të vazhdojnë të lulëzojnë në ju dhe në Kosovë, Ju jeni në mendjet dhe lutjet e shumë miqve gjithandej. Andaj edhe pse jeni të burgosur, kjo nuk ju pengon të vazhdoni të

bëni mirë. Ju, miqtë e mi, keni ende shumë për të bërë dhe mund të bëni gjëra të mëdha për familjet dhe vendin tuaj. Së fundmi, ndërsa lutemi për ju sot, dua t'ju inkurajoj t'u bëni thirrje bashkëkombësve tuaj të luten gjithashtu me ju dhe për vendin tuaj. Kur isha në Kongres, udhëhoqa një përpjekje për të njohur të Enjten e parë të majit si Ditën Kombëtare të Lutjes, të cilën presidenti Reagan e nënshkroi si ligj.

Vitin e kaluar u ftova në Ukrainë për t'u takuar me parlamentin e tyre për krijimin e një dite të ngjashme kombëtare lutjeje në vendin e tyre. Ata e miratuan atë ligj katër muaj më parë dhe tani ShBA-ja dhe Ukraina janë të vetmet dy vende me një ditë kombëtare lutjeje. Unë besoj se kur një komb përulet në lutje, Zoti dëgjon. Imagjinoni çfarë mund të ndodhte nëse ju së bashku do të mund t'i thërrisnit bashkatdhetarët tuaj në një ditë lutjeje për kombin tuaj. Faleminderit, vëllezër të dashur, që morët letrën time dhe për mikpritjen e familjeve tuaja që më pritën në Kosovë gjatë vizitës sime të fundit para dy vitesh. Jam këtu me miqtë që kam sjellë nga vendi im dhe nga Kosova për t'u lutur me ju dhe për ju. Mbahuni të fortë dhe të guximshëm, keni ende shumë për të bërë dhe keni mjetet shpirtërore për ta bërë këtë.

Në emër të Jezusit,

Vëllai dhe miku juaj,
Tony Hall

Veprimtari Sali Bislimi kritikon Specialen: Thaçi do të dalë edhe më i fortë

PRISHTINË, 23 MAJ - Veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, që është drejtor i zyrës ligjore First-consulting.ch në Bern dhe Delemont të Zvicrës, ka komentuar procesin gjyqësor të Gjykatës Speciale në Hagë. Ai ka thënë se në emër të një aktakuze të rrejshme e ngritën një proces gjyqësor i cili prodhoi 3 milionë faqe turpi.

Bislimi ka thënë se ish-presidenti Hashim Thaçi nga ky proces do të dalë edhe më i fortë. “Procesi toksik afatgjatë i Gjykatës Speciale ndërtoi një rreth vicioz akuzash të pabaza dhe mbjelli mosbesimin e ndërsjellë. Hedhja fajit në mënyrë sistematike presidentit Thaçi nuk i kontribuon as drejtësisë as shoqërisë. Në emër të një aktakuze të rrejshme e ngritën një proces

gjyqësor, i cili prodhoi 3 milionë faqe turpi për ta hutuar botën demokratike dhe manipuluar drejtësinë në shpinë të një Kosove frazhile, e cila sapo e vuri themelin e shtetësisë dhe pa asnjë ditë provoje demokracie e sulmuan me xhelozë barbarie! Hashim ke me dalë me i fort. Zoti është me ty”, ka shkruar Bislimi në “Facebook”.



BLLOKADA NË KUVEND, KOMF-i: KARRIGET TUAJA NUK VLEJNË MË SHUMË SE JETA DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 MAJ - Në shenjë pakënaqësie rreth moskonstituimit të Kuvendit dhe ndikimit të kësaj bllokade në shumë procese të mbrojtjes së fëmijëve, Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) ka organizuar aktivitetin me moton “Karriget tua nuk vlejnë më shumë se jeta dhe mirëqenia e fëmijëve”. Qëllimi i këtij aktiviteti është të nxisë reflektim dhe përgjegjësi institucionale të deputetëve ndaj realitetit të vështirë me të cilin përballen shumë fëmijë në Kosovë dhe nevojave të tyre. Si pasojë e kësaj bllokade, shumë politika që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien dhe jetën e fëmijëve vazhdojnë të mbesin të pamiratuara.

Stagnimi i politikave dhe reformave në fushën sociale

Sipas KOMF-it, reformat e domosdoshme për riorganizimin dhe fuqizimin e politikave sociale kanë stagnuar. “Vazhdon të mungojë miratimi i disa projektligjeve kyçe, si: Projektligji për Ndhimën Sociale; Projektligji për të Drejtat, Vlerësimin, Trajtimin dhe Njohjen e Statusit, Shërbimet dhe Përfitimet për Personat me Aftësi të Kufizuara; Projekt Kodi Civil si dhe reforma që rrjedh nga Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare. Të gjitha këto procese janë thelbësore për zbutjen e varfërisë së fëmijëve,

fuqizimin e familjes dhe mbrojtjen e fëmijëve, me fokus të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve të cenueshëm”, ka vlerësuar KOMF.

Stagnimi i politikave për shëndetin e fëmijëve

KOMF-i ka vlerësuar se politikat në fushën e shëndetit të fëmijëve kanë stagnuar. “Ende nuk janë miratuar disa projektligje të rëndësishme, përfshirë: Projektligjin për Shëndetësi, Projektligjin për Shëndetin Mendor, Projektligjin për ndalimin e pijeve energjike për personat nën moshën 18 vjeç, etj. Zvarritja e këtyre proceseve ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e fëmijëve, duke penguar qasjen e tyre në shërbime shëndetësore cilësore dhe në kujdesin e duhur shëndetësor”, ka theksuar KOMF.

Mungesa e buxhetit për mbrojtje të fëmijëve

“Pa një Kuvend të konstituuar nuk mund të ketë investime domethënëse në mbrojtjen e fëmijëve. Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal mbetet i pamiratuara. Përmes këtij projektligji parashihet që të bëhet zgjidhje e qëndrueshme e financimit të shërbimeve sociale të ofruara për fëmijët dhe familjet e cenueshme, përmes ndarjes së buxhetit të veçantë për shërbime sociale. Aktualisht ofruesit e shërbimeve sociale, goftë ata publikë si qendrat për punë sociale, goftë ata



joqeveritarë, janë në gjendje shumë të rëndë për shkak të mungesës së financimit, burimeve njerëzore dhe infrastrukturës adekuate”, thuhet në reagimin e KOMF-it.

Roli mbikëqyrës i Kuvendit dhe ndikimi i mungesës së tij në mbrojtjen e fëmijëve

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi ka edhe mandat mbikëqyrës, përfshirë monitorimin e zbatimit të ligjeve të miratuara. KOMF-i ka theksuar se mungesa e një Kuvendi të konstituuar ndikon drejtpërdrejt në uljen e nivelit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. “Kjo krijon vakum institucional dhe rrezikon përkeqësimin e situatës së fëmijëve, veçanërisht atyre në rrethana të cenueshme. Situata e

fëmijëve në Kosovë mbetet e vështirë. Sipas të dhënave të fundit të disponueshme, 72% e fëmijëve në Kosovë përjetojnë forma të dhunshme të disiplinimit brenda mjediseve familjare. 5 % e fëmijëve në Kosovë janë të përfshirë në punë të rënda. Vetëm 10% e fëmijëve me aftësi të kufizuara marrin shërbime cilësore shëndetësore dhe sociale. Vetëm 15% e fëmijëve në Kosovë të moshës 3-4 vjeç ndjekin programet e zhvillimit në fëmijërinë e hershme”, ka theksuar KOMF-i. Vlerësohet se numri i përgjithshëm i përdoruesve të substancave narkotike ka kaluar shifrën prej 30 000, ndërkohë që fëmijët dhe adoleshentët përdorues vazhdojnë të bëjnë pjesë çdo vit e më shumë në këtë shifër. “Jashtëzakonisht shqetësues mbetet fakti që moshë mesatare e fillimit të përdorimit të drogave është në rënie, ku nga 18 vjeç në vitin

2018, në 16 vjeç në periudhën e fundit. Kalueshmëria në testin e arritshmërisë për vitin 2023 ishte vetëm 52.1%, ndërkaj, “PISA” e ka renditur Kosovën në vendin e 76-të nga 80 vende pjesëmarrëse. Gjatë vitit 2023, numri i fëmijëve në konflikt me ligjin që është raportuar nga Policia e Kosovës, ka qenë 2175 fëmijë”, është thënë në reagimin e KOMF-it. KOMF-i kërkon që deputetët të reflektojnë mbi peshën e përgjegjësisë së tyre. KOMF-i konsideron që deputetët duhet ta marrin përgjegjësinë e tyre kushtetuese dhe ligjore për të vepruar urgjentisht për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. “Çdo vendim që dështojnë apo vonojnë ta marrin për fëmijët, është një barrë që fëmijët e paguajnë me shëndetin, mirëqenien dhe shpesh jetën e tyre”, është theksuar në reagimin e kësaj organizate.

Ambasadori Dugolli takon kongresisten Greene, flasin për avancimin e partneritetit Kosovë - ShBA

PRISHTINË, 23 MAJ - Ambasadori i Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ilir Dugolli, ka takuar kongresisten republikane Marjorie Taylor Greene. Në “X” të Ambasadës së Kosovës në ShBA thuhet se takimi riafirmoi angazhimin e

përbashkët për thellimin e bashkëpunimit dypalësh dhe forcimin e lidhjeve unike. “Ambasadori Ilir Dugolli u takua me kongresmenen republikane Marjorie Taylor Greene, patën diskutim produktiv mbi avancimin e partneritetit Kosovë-ShBA. Takimi riafirmoi angazhimin

tonë të përbashkët për thellimin e bashkëpunimit dypalësh dhe forcimin e lidhjeve tona unike”, thuhet në postimin për medie. Kongresistja amerikane, republikania Greene, është bashkëpunëtorë e afërt e presidentit amerikan Donald Trump.



Dita kur gjithçka ndryshoi: Rrëfimet nga Izraeli për 7 tetorin tregohen në UP

PRISHTINË, 23 MAJ - Në Sallën e Senatit të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës u promovua antologjia me rrëfimet e atyre që përjetuan ngjarjet e 7 tetorit të vitit 2023 në Izrael.

Në hapje të ngjarjes, prorektorja për bashkëpunim ndërkombëtar, prof. Rozafa Basha, dhe prorektori për shkencë, prof. Avni Hajdari, mirëpritën ambasadorën e Izraelit në Kosovë, Tamar Ziv,

që ishte e pranishme në promovimin e antologjisë. Për antologjinë me ilustrime, të titulluar “Dita kur gjithçka ndryshoi: Dhjetë histori nga 7 tetori”, hollësi para të pranishmëve dhanë redaktorja Netta Gurevitch dhe ilustruesja Danielle Peleg. Bisedën dhe diskutimet me to i drejtoi profesoresha e Departamentit të Gazetarisë, prof. Remzije Shahini-Hoxha. Antologjia është një vepër

artistike dhe dokumentuese që përmbledh rrëfime personale dhe tragjike nga ngjarjet e 7 tetorit - sulmit më të madh brenda territorit të Izraelit pas luftës arabe-izraelite.

Ambasadorja e Izraelit në Kosovë, Tamar Ziv, vizitoi Rektoratin e Universitetit të Prishtinës edhe në janar të këtij viti, kur u diskutua për bashkëpunimet e UP-së me universitete izraelite.



KALLASI NË VERI: E RËNDËSISHME TË DËSHMOJMË VETË SE ÇFARË PO NDODH NË TERREN

MITROVICË, 23 MAJ - Shefja e diplomacisë së Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, në përfundim të vizitës në Kosovë të premten, e vizitoi edhe Mitrovicën e Veriut, zyrën e EULEX-it dhe u takua me përfaqësues të arsimit dhe sistemit të drejtësisë.

Në një deklaratë të shkurtër për medie në Mitrovicën e Veriut, Kallasi tha se ishte e rëndësishme shkuarja në pjesën veriore të Kosovës, sepse “atje dëgjohen narrativa të ndryshme”. “Është e rëndësishme të dëshmojmë vetë se çfarë po ndodh në terren dhe çfarë thonë njerëzit. Vizitova gjykatën që funksionon dhe që po pret kthimin e gjyqtarëve serbë. Gjithashtu, u

takova me përfaqësues të shkollave këtu për ta kuptuar më mirë situatën, për të biseduar me qytetarët dhe për të parë me sytë e mi se çfarë ndodh në këtë pjesë”, deklaroi ajo.

Qindra pjesëtarë të komunitetit serb në veri dhanë dorëheqje nga institucionet e Kosovës, përfshirë komunat, policinë, gjykatat dhe prokurorinë, në nëntor të vitit 2022, pas një vendimi të Qeverisë së Kosovës për t'i zëvendësuar targat serbe të makinave me targa të Kosovës.

Nga ajo kohë kryetarët e komunës Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq u zëvendësuan me udhëheqës shqiptarë, pasi



komuniteti shumicë serb në zonë i bojkotoi zgjedhjet.

Në gjykata, prokurori dhe polici, punonjësit serbë nuk u kthyen

më.

Në “Instagram”, të shoqëruar me video nga takimi në gjykatë, Kallasi shkroi se Bashkimi Evropian mbetet i mendimit se “kthimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit serb të Kosovës është thelbësor për drejtësinë, stabilitetin dhe bashkëjetesën shumëtnike”.

Në Mitrovicën e Veriut, Kallasi shtoi se forcat ndërkombëtare ofrojnë një pasqyrë të qartë dhe reale të situatës në terren, për të cilën “njëra palë thotë një gjë, ndërsa pala tjetër diçka tjetër”.

“Është thelbësore të flitet me njerëzit në terren për të parë se çfarë mund të bëjmë më shumë që e ardhmja të jetë e sigurt dhe e begatë për të gjithë në Kosovë”, përfundoi ajo.

KRYETARI I PDK-së: MUNGESA E DREJTËSISË PËR VIKTIMAT E DUBRAVËS, NJË PLAGË E HAPUR PËR KOSOVËN



PRISHTINË, 23 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka përkujtuar 24-vjetorin e njëres prej ngjarjeve më të errëta të historisë sonë të re, masakrën në Burgun e Dubravës, ku nga 19 deri më 24 maj të vitit 1999, forcat kriminale serbe masakruan mizorisht 117 të burgosur shqiptarë dhe plagosën mbi 200 të tjerë.

Krasniqi tha se kjo masakër, ashtu si edhe shumë krime të tjera të kryera ndaj popullit të Kosovës, përbën një dëshmi të qartë të gjenocidit të planifikuar

nga regjimi serb ndaj popullatës shqiptare. Ai ka theksuar se kujtimi i kësaj tragjedie na rikujton çmimin e lartë të lirisë që e gëzojmë sot dhe domosdoshmërinë për të mos e harruar kurrë sakrificën. “Me dhembje të madhe përkujtojmë 117 të burgosurit shqiptarë që u vranë në mënyrë çnjerëzore nga regjimi serb. Nderojmë të gjithë të mbijetuarit e kësaj masakre, që patën forcën të dëshmojnë për tmerrin e përjetuar dhe t'i tregojnë botës së vërtetën e dhimbshme të Dubravës”, u

shpreh Krasniqi.

Ai theksuar se më e pakta që mund të bëhet është që autorët e kësaj masakre të dalin para drejtësisë dhe ta marrin dënimin e merituar. “Mungesa e drejtësisë për viktimat e Dubravës është një plagë e hapur për Kosovën. Ne do të vazhdojmë të kërkojmë drejtësi - jo për hakmarrje, por për të vërtetën dhe për të ardhmen. Lavdi e përjetshme për viktimat e masakrës në Burgun e Dubravës”, ka thënë kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi.

Besnik Tahiri bisedon në “zoom” me dekanin e Bush School, John B. Sherman

PRISHTINË, 23 MAJ - Nën kryetari i AAK-së, Besnik Tahiri, ka mbajtur një takim në “zoom” me John B. Sherman, dekanin e Bush School of Government and Public Service në Universitetin Texas A&M, me të cilin ka diskutuar për pjesëmarrjen e mundshme të Shkollës si prezantuese në Konferencën Ndërkombëtare për Qeverisje – Tirana 2025. “I jam veçanërisht mirënjohës dhe falënderues z. Harry

Hardman, kryetar i Bashkisë së qytetit Conroe, në Teksas të ShBA-së, që iu bashkua takimit dhe ndihmoi në organizimin e këtij diskutimi të rëndësishëm. Një falënderim i veçantë i shkon edhe mikut tim dhe të shqiptarëve, Joe Haliti, për mbështetjen e vazhdueshme”, ka theksuar Tahiri.

Ai ka thënë se Bush School është një institucion lider në adresimin e sfidave aktuale të

qeverisjes dhe në nxitjen e inovacionit në politikëbërjen publike.

“Padyshim ky është hap përpara që shkolla prestigjioze për qeveri, George Bush nga Texas, t'i japë karakter shkencor ndërkombëtar Konferencës për Qeverisje Tirana 2025. Presim me padurim ta konfirmojmë pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në javët në vijim”, ka thënë Tahiri.



DEFICITI TREGTAR I KOSOVËS NË MUAJIN PRILL ARRITI NË 15,2 PËR QIND

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin prill 2025. Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 15,2 % në muajin prill 2025 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2024, gjegjësisht në vlerë prej 492,3 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 427,5 milionë eurosh në vitin 2024. Eksporti mbulon importin 13 %. Eksporti i mallrave në muajin prill 2025 kishte vlerën 73,8 milionë euro, ndërsa importi 566,2 milionë euro, që është një rritje prej 0,9 % për eksport, si dhe një rritje prej 13,1 % për import, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit, 23,1 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 13,9 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 11,8 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura; 10,1 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; pijet dhe



duhani; 6,8 % e përbëjnë produktet minerale etj. Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 12,9 % e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 12,8 % e përbëjnë produktet minerale; 12,6 % e përbëjnë mjetet e transportit; 11,1 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 9,1 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre etj.

Eksportet dhe importet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 25,3 milionë euro ose rreth 34,2 % e eksporteve të përgjithshme me një rritje prej 1,2 %. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (12 %), Holanda (3 %), Italia (2,8 %), etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin

rreth 237,6 milionë euro, ose 42 % e importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-2,4 %). Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (13,9 %), Italia (4,6 %), Polonia (3,8 %) etj.

Eksportet dhe importet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 33,9 milionë

euro, ose 45,9 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 4,1 %. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (15,9 %), Shqipëria (15,5 %), Mali i Zi (7 %), Serbia (6 %).

Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 74,3 milionë euro, ose 13,1 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 13,5 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (4,6 %), Shqipëria (3,8 %), Serbia (3,4 %).

Eksportet dhe importet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 14,6 milionë euro, ose 19,8 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (9,5 %) dhe ShBA-ja (2,8 %). Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 254,3 milionë euro, ose 44,9 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (14 %) dhe Kina (13 %).

ZRRE THOTË SE LIBERALIZIMI I TREGUT PËR ENERGJI NIS MË 1 QERSHOR

PRISHTINË, 23 MAJ - Zyra e Rregullatorit për Energji ka mbajtur takim me furnizuesit e licencuar për furnizim me energji elektrike në vend. Ajo ka njoftuar se janë përmbyshur kushtet e nevojshme për fillimin e funksionimit të tregut të liberalizuar të energjisë elektrike më 1 qershor pavarësisht prej kundërshtimeve se kjo do t'i dëmtojë bizneset. Në takim morën pjesë edhe furnizuesit të licencuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, duke reflektuar njohjen reciproke të licencave ndërmjet vendeve të rajonit. Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, në takim me furnizuesit e licencuar, theksoi



rëndësinë e transparencës dhe informimit të saktë të konsumatorëve gjatë këtij tranzicioni. Ai nënvizoi se roli i rregullatorit do të mbetet kyç në monitorimin dhe garantimin e një tregu të drejtë dhe

konkurrues. Ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka theksuar rëndësinë e përgatitjeve të përbashkëta për kalim të suksesshëm drejt tregut të liberalizuar të energjisë

elektrike, ndërsa furnizuesit e licencuar shprehën gatishmërinë për t'i ofruar ofertat për konsumatorët që shprehin interesim për furnizim në tregun e lirë. Po ashtu, ata u zotuan për një

bashkëpunim të vazhdueshëm me ZRrE-në dhe për ofrimin e informacioneve të nevojshme për konsumatorët që kërkojnë sqarime lidhur me kalimin në tregun e liberalizuar. Në takim u konstatua se janë përmbyshur të gjitha kushtet e nevojshme për fillimin e funksionimit të tregut të liberalizuar të energjisë elektrike, i cili do të nisë zyrtarisht më 1 qershor 2025. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë ka paralajmëruar se do ta nisë betejën ligjore për ta kundërshtuar vendimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për liberalizimin e shpejtë të tregut të energjisë, pasi është marrë pa një analizë të mirëfilltë dhe pa asnjë konsultim me palët e interesit. (Ksp)

Guvernatori i BQK-së dhe ekspertët e Misionit të FMN-së diskutojnë për përparimin e reformës së mbikëqyrjes bankare

PRISHTINË, 23 MAJ - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, së bashku me zëvendësguvernatorin Milot Cakaj dhe bashkëpunëtorët e tij, zhvilloi takim me ekspertët e lartë të angazhuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), në përbërje të Valter Borges de Araujo Neto dhe Rita

Tam, në kuadër të asistencës teknike të FMN-së. Gjatë këtij takimi është diskutuar mbi ecurinë e zhvillimeve për avancimin e procesit të rishikimit mbikëqyrës sipas aktiviteteve të parapara në udhërrëfyesin e miratuar nga BQK për Zbatimin e Procesit të Rishikimit Mbikëqyrës për

Banka (SREP). Guvernatori Ismaili theksoi përkushtimin e BQK-së për të ndërtuar një sistem mbikëqyrës të fortë, transparent dhe në përputhje me kërkesat e një tregu financiar modern dhe të integruar. Ndërsa ekspertët e FMN-së vlerësuan përparimin e arritur nga BQK-ja në aktivitetet e



parapara në udhërrëfyesin e miratuar për SREP dhe shprehën gatishmërinë për të

ofruar mbështetje teknike dhe këshillimore në fazat e ardhshme të reformës.

RREZIQET E LUKSIT, MËSIME NGA NJË PERANDORI

A jemi të skllavëruar nga gjërat e bukura të jetës?

Shkrimtari romak, Taciti, argumentonte se Perandoria Romake u ndërtua duke skllavëruar popujt e pushtuar, të cilët më pas u mësuan me një mënyrë jetese të re plot luks dhe rehati. Teknologjia sot është bërë aq thelbësore në jetën tonë të përditshme, sa duket e pamundur të shkëputemi prej saj. Ajo është po aq një kafaz, sa edhe një luks. Të varurit nga diçka, i jep asaj gjëje pushtet mbi ty. Të kesh nevojë për diçka ose dikë është, për mirë a për keq, të kufizosh veten

Philippa ka vendosur të largohet nga rrjetet sociale. Ajo është e shqetësuar për sa shumë tërheqëse dhe varësuese janë, dhe mendon se nuk i sjellin asnjë të mirë. Por pastaj mendon: Po si do flasë me hallën në Afrikën e Jugut? Çfarë do të ndodhë me të gjitha fotot e saj? Si do të organizojë festa? Trevor dëshiron të largohet nga vendi. Ai nuk i beson qeverisë, nuk i pëlqejnë njerëzit dhe urren motin. Por pastaj kujton se kujdesi shëndetësor që merr është i mirë. Dhe pëlqen televizorin. Edhe rrugët janë mjaft të mira. Philippa dhe Trevor janë dy shembuj të mënyrës se si luks, teknologjia dhe rehatia e jetës mund të na zënë në kurth. Në shumë drejtime, kjo është një dukuri moderne dhe e prekshme, por ajo i përket kohëve të lashta – të paktën që nga koha e Tacitit. Është ideja se zbukurimet e qytetërimit na skllavërojnë. Si ka mundësi që, pa e kuptuar fare, gjërat që i mendonim të dobishme dhe që kursenin kohë, janë shndërruar në gjëra të domosdoshme?

Rreziku i fshehur i luksit

Ushtria romake ishte një nga forcat më të efektshme dhe të suksesshme ushtarake që ka njohur ndonjëherë bota. Në fushë të hapur, legionet e tyre ishin praktikisht të pathyeshme. Por Perandoria Romake nuk u ndërtua vetëm falë gjenialitetit ushtarak dhe shpatave të shkurtra me goditje të fuqishme. Legionet mund të mposhtnin një popull, por nuk e nënshtrojnë atë. Ishte dashuria për luksin dhe rehatinë që i nënshtroi.

Britanikët, shkruante Taciti, u skllavëruan jo nga zinxhirët, por nga dëshira për verë të mirë dhe darka elegante. Madje, guvernatori i Britanias, Agrikola, qëllimisht përpiquej ta qetësonte këtë shoqëri luftëtarësh fisnorë me “shpërqendrime të këndshme” si: banja të



ngrohta, toga, dhe arsimim. Siç shkruante Taciti: “Britanikët naivë i quanin këto gjëra ‘qytetërim’, kur në fakt ishin thjesht pjesë e skllavërimit të tyre.” Rehatia dhe komoditeti i shndërruan luftëtarët britanikë me fytyra të lyera dhe britma në civilë të butë dhe të pajtueshëm. (Duhet theksuar se Taciti ka të ngjarë t’i ketë ekzagjeruar këto. Britania nuk ishte kurrë aq e bindur sa Franca apo Spanja në Perandorinë Romake.) Përdorimi i luksit për të bërë për vete një popull është një taktikë që është përsëritur gjatë gjithë historisë. E përballur me një deficit tregtar me Kinën, Perandoria Britanike e dëndi vendin me opium të lirë të sjellë nga India. Një drogë luksi u kthye në varësi, dhe britanikët e shkëm-

benin opiumin për porcelan, çaj dhe mëndafsh. Lufta e Ftohtë u fitua gjithashtu përmes luksit. Kur televizorët dhe frigoriferët amerikanë të lirë filluan të depërtonin në BRSS, sovjetikët nuk kishin më mundësi të konkurronin me një jetë të tillë të rehatshme. Blloku komunist filloi të shihte mallrat “luksoze” të jetës së përditshme si thelbësore – dhe vetëm SHBA mund t’ua ofronte ato. Por shembulli më i prekshëm për shumicën prej nesh sot është marrëdhënia jonë me Big Tech. Kompani si Facebook, Apple dhe Google i kanë lidhur jetët tona gjithnjë e më shumë me algoritmet dhe platformat e tyre. Rrjetet sociale janë krijuar dhe të kalibruara për të qenë qëllimisht varësuese. Shërbime që kursejnë kohë apo para, si

ruajtja e të dhënave në “cloud”, janë bërë aq të zakonshme, sa kthimi pas është bërë thuajse i pamundur. Gjithnjë e më shpesh ndodh që as nuk e dimë më fjalëkalimin tonë – ia lëmë telefonit ose një aplikacioni ta krijojë dhe ruajë për ne.


Nuk mund të largohesh nga makina

Një teknologji apo shërbim i ri fillimisht është një luks – derisa bëhet aq i zakonshëm dhe i kudondodhur, aq thelbësor – sa nuk mund të kthehesh më pas në kohën para se të ekzistonte. Ajo që dikur ishte një “dëshirë”, kthehet në një “nevojë”. Novela e E.M. Forster, “Makina ndalet” (The Machine Stops), përfytyron një botë ku çdo aspekt i jetës ofrohet nga “makina”. Ka butona për “të kërkuar

ushqim, muzikë, rroba, banja të ngrohta, letërsi dhe, sigurisht, komunikim me miqtë.” Sa profetike ka qenë kjo vepër? Sot kemi Uber, Skype, Hello Fresh dhe Amazon Prime. Edhe miqtë dhe familjarët tanë janë të lidhur me makinën.

A është e mundur të largohemi?

Edhe pse teknologjinë e shohim si çlirimtare, ajo na mbyll në kuti. Nëse i besojmë Tacitit, tani jemi skllavër të gjërave që dikur i mendonim si luks. Detyra e filozofisë është t’i shohë këto zinxhirë për atë që janë. Dhe, ndërsa shqyrtojmë jetët tona, mund të zgjedhim t’i mbajmë ato zinxhirë me vetëdije, ose të nisim rrugëtimin e gjatë e të vështirë për t’i hequr. / big think – bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Rahoveci, kampion i Kosovës në hendboll

FERIZAJ, 23 MAJ - Rahoveci është shpallur kampion i Kosovës në hendboll në konkurrencën e meshkujve. Titullin e dytë rresht Rahoveci e ka fituar kundër Kastriotit në palestrën “Bill Clinton” në Ferizaj. Në finalen e dytë të playofit, Rahoveci e ka mposhtur

Kastriotin me rezultat 34:32. Rahovecasit e kanë fituar edhe finalen e parë të dielën. Ndeshja e dytë ishte një dramë e vërtetë. Mysafirët ishin në epërsi të lehtë thujse gjithë kohën, por ferizajasit nuk u dorëzuan. Në minutën e 54 shënuan për 23:22. Më pas u

shkëputën edhe në dy gola, 24:22. Humbën sulmin për shkëputje prej tri golave dhe Rahoveci u kthye. Egzon Gjuka shënoi fare në fund për 26:26. Ndeshja ka shkuar në vazhdim nga pesë minuta. Lojtarët e Rahovecit shfaqën më shumë dhe fituan në fund

34:32.

Gjuka e Alban Haziri i shënuan nga shtatë gola te Rahoveci. Nga pesë i shtuan Mali Luzha e Arbios Mushkolaj, ndërsa gjashtë gola, katër nga penalltia, i realizoi Victor Alonso. Te Kastrioti nëntë gola i shënoi Deniz Terziqi. Pesë



Lulzim Shabani e gjashtë Yassine Henahen, pesë prej tyre nga penalltia. Pritje të shumta sërish kishte Wadi Chebbi.

Prishtina fiton Kupën e Kosovës, siguron daljen në Evropë

PRISHTINË, 23 MAJ - Prishtina është fituese e edicionit 2024/25 të Kupës së Kosovës në futboll. Në finalen e zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri” në kryeqytet, në prani të rreth 10 mijë tifozëve, skuadra e kryeqytetit e ka mposhtur Llapin me rezultat minimal 1:0, duke e siguruar trofeun për herë të nëntë në histori dhe për herë të dytë në tri edicionet e fundit.

Trofeun kapitenit të Prishtinës, Drilon Islamit, ia ka dorëzuar presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, pas një ceremonie solemne në fund të ndeshjes, derisa trofeun deri aty e ka bartur futbollisti i Kombëtares së Kosovës, Valon Berisha. I pranishëm në ndeshje ishte

edhe përzgjedhësi i kombëtares, Franco Foda, si dhe përfaqësues të institucioneve, derisa drejtësinë në këtë finale e ndau gjyqtari nga Gjermania, Robert Schroder, së bashku me pesë gjyqtarë të tjerë gjermanë. Golin e vetëm dhe vendimtar për Prishtinën e realizoi mesfushori Albin Krasniqi në minutën e 61-të, me një goditje të fuqishme nga zona, e cila është devijuar nga mbrojtësi i Llapit, Diar Vokrri dhe ka përfunduar në rrjetën e portierit kroat, Marijan Çoriq. Pak çaste para golit, Llapi ka mbetur me një lojtar më pak, pasi mesfushori Arbnor Ramadani është përjashtuar pas një ndërhyrje të ashpër në mesin e fushës, duke ia



vështirësuar punët skuadrës në vazhdim të ndeshjes. Pavarësisht prej angazhimit dhe përpjekjeve, Llapi nuk ka arritur ta gjejë golin e barazimit dhe kështu mbetet me dy trofe të fituar në këtë garë, ndërkohë që për Prishtinën kjo ishte finalja e tretë radhazi në Kupën e Kosovës. Edhe në finalen e edicionit 2022/23 Prishtina

kishte triumfuar, duke e mposhtur Gjilanin me rezultat 2:0, ndërsa vitin e kaluar ka humbur ndaj Ballkanit pas penalltive (4:2), pasi ndeshja ishte mbyllur 2:2 pas kohës së rregullt dhe vazhdimëve. Prishtina, përveç trofeut prestigjioz, ka siguruar edhe pjesëmarrjen në garat evropiane. Me këtë rast,

presidenti i FFK-së, Agim Ademi, e ka uruar Prishtinën për suksesin e arritur përmes një mesazhi në rrjete sociale. “Finalja ishte dëshmi e profesionalizmit dhe karakterit të skuadrës suaj. Me një paraqitje të shkëlqyeshme arritët të fitoni ndaj një kundërshtari të fortë si FC Llapi (1:0), duke u dhënë krenari tifozëve tuaj dhe gjithë kryeqytetit. Ky sukses është fryt i përkushtimit, bashkëpunimit dhe punës së palodhshme të çdo hallke në klubin tuaj. Urime të përzemërta për futbollistët, stafin teknik, drejtuesit e klubit, tifozët besnikë ‘Plisat’ dhe të gjithë qytetarët e Prishtinës për këtë arritje. Urime dhe suksese në Evropë!”, ka shkruar Ademi.

Manchester Unitedi i vë në shitje të gjithë lojtarët

MANCHESTER, 23 MAJ - Manchester United i ka vënë në dispozicion të gjithë lojtarët e skuadrës për shitje pas humbjes së mbrëmshme në finalen e Ligës e Evropës, sipas medieve angleze. Ata jo vetëm që humbën një trofe të madh, por edhe kualifikimin në Ligën e Kampionëve, me Dajtë e Kuq që do ta humbasin futbollin evropian sezonin e ardhshëm. Humbja e ka lënë Man Unitedin në një situatë të vështirë financiare përpara verës, e cila do ta



shënojë parasezonin e parë të Ruben Amorim pas emërimit

të tij në pozitën e trajnerit nëntorin e kaluar. Hierarkia e

klubit, e cila përfshin emra si Sir Jim Ratcliffe dhe Omar Berrada, shpresonte të fitonte 100 milionë euro nga kualifikimi për Ligën e Kampionëve. Pa një vend në Ligën e Kampionëve, Man United mund të detyrohet të ndërmarrë veprime drastike. Sipas “Mirror”, Man Unitedi do t’i “dëgjojë ofertat për çdo lojtar” pas zhgënjimit në finalen e Ligës së Evropës. Asnjë lojtar nuk do të jetë “imun nga shitja”, që do të thotë se kapiteni i klubit

Bruno Fernandes mund të shitet këtë verë për ta zgjidhur “vimën e zezë financiare katastrofike” të klubit. Fernandes është lidhur fort me një largim nga Old Trafford. Skuadra e Ligës Profesionale Saudite, Al Hilal, ka kontaktuar kampin e lojtarit në lidhje me një transferim. Ata janë të përgatitur ta thyejnë rekordin britanik të transferimeve dhe t’i paguajnë atij afër 200 milionë euro për një kontratë trevjeçare.

Ancelotti sot drejton ndeshjen e fundit si trajner i Real Madridit

MADRID, 23 MAJ - Real Madridi dhe Carlo Ancelotti kanë arritur një marrëveshje për t’i dhënë fund bashkëpunimit. Reali ka njoftuar edhe zyrtarisht ndarjen e rrugëve me trajnerin italian Ancelotti pas një epoke të dytë shumë të suksesshme së bashku. “Real Madridi dhe Carlo

Ancelotti kanë arritur një marrëveshje për t’i dhënë fund mandatit të tij si trajner i Real Madridit. Klubi ynë dëshiron ta shprehë mirënjohjen dhe dashurinë e tij për një nga legjendat më të mëdha të Real Madridit dhe të futbollit botëror”, ka njoftuar klubi spanjoll.

Ancelotti e ka udhëhequr ekipin spanjoll drejt një prej periudhave më të suksesshme në historinë 123-vjeçare dhe është bërë trajneri me më shumë tituj në histori: 3 Liga të Kampionëve, 3 Kupa të Botës për Klube, 3 Superkupa të Evropës, 2 tituj La Liga, 2 Copa del Rey dhe 2 Superkupa

Spanjolle. Në total, 15 tituj gjatë gjashtë sezoneve që ai ka qenë me klubin mbretëror. Sot (e shtunë) “Santiago Bernabeu” do t’i bëjë nderim atij në atë që do të jetë ndeshja e fundit e Carlo Ancelottit si trajner i Real Madridit. Xabi Alonso pritet të vijë si pasues i tij te “Los Blancos”.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 927/1
Datë: 23.05.2025

Bazuar në nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 08/L-197, nenin 35 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, nenin 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Rregulloren 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Udhëzimit administrativ 05/2012, Udhëzimit administrativ 05/2015, Udhëzimit administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPARr-së, shpall këtë:

KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur

Qendra e Kompetencës “11 Marsi” në Prizren

Titulli i vendit të punës: Drejtor i Qendrës të Kompetencës
Numri i pozitave: Një (1) pozitë
Lloj pozitës: Nëpunës i shërbimit publik
Klasa/Koeficienti: E 13-6.8
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet, me mundësi vazhdimi

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

Drejtori i IEAAP ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës, sigurimi dhe përditësimi i të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor;
- Vlerësimin e mësimdhënësve, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me Këshillin Drejtues të Institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsimin parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI dhe obligimet që dalin nga rregullorja për arsim;
- Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori/esha e agjencisë së AAPARr-së, në pajtim me ligjin.

Kushtet që duhet t’i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.3. Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 1.6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- 1.7. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për Qendrat e Kompetencës (përgatitje profesionale për profile përkatëse të institucionit ku konkurron);
- 1.8. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- 1.9. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
- 1.10. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- 1.11.Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit/es sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
- 1.12.Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
- 1.13. Të ketë të paktën pesë (5) vite përvojë pune si mësimdhënës/e në IEAA-AP;
- 1.14. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në legjislacioni në fuqi.

Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të kenë këto dokumente:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit sipas pikave 1.7, 1.8, 1.9 apo 1.10 të këtij neni;
- Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
- Nëse kandidati/ja ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, nuk obligohet të dorëzojë dëshminë/certifikatën e trajnimit për udhëheqje në arsim sipas pikës 1.12 të këtij neni;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Vërtetimin e përvojës së punës në procesin edukativo-arsimor;

- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- Portfolion profesional me dëshmi sipas udhëzimeve në formularët e Rregullores 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar;
- Për pozitat e drejtorëve të shkollave, kandidatët dorëzojnë konceptin e një plani zhvillimor të shkollës, i cili përshkruan konkretisht mënyrën dhe strategjinë përmes së cilës do të përmirësohet cilësia menaxheriale e shkollës, mësimdhënia dhe rezultatet e nxënësve të shkollës;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga MASHTI;
- Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar me këtë nen, dorëzohet në kopje fizike në zyrën dhe afatin e përcaktuar me konkurs publik.

Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatës

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portfolios profesional, Planin Zhvillimor të institucionit mund ta merrni në Qendrën e Kompetencës “11 Marsi” në Prizren.

Vlerësimi i kandidatëve:

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë;
- Intervista me gojë, përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm, 30% prezentimi i konceptit të planit zhvillimor të shkollës dhe 20% portfolio profesionale;
- Komisioni bën përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues të vlerësuar me më së shumti pikë, por të paktën 70% të pikëve totale sipas formularit përkatës të kësaj Rregulloreje;
- Lista e ngushtë e aplikuesve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave, do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit;
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do t’u dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit nga dt. 24.05.2025 deri me dt. 22.06.2025.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr). Adresa: Rruga “Agim Ramadani” 10000, Prishtinë, kati i tretë, duke filluar nga ora 09.00-15.00. Aplikacioni merret dhe dorëzohet në administratën e AAAPARr-së. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen, përveç diplomave të noterizuara. Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion).

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar, kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.

Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, ata duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs, nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Edona Berisha shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Qlirim Mustafaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

**Republika e Kosovës****Republika Kosovo-Republic of Kosovo- Kosova Cumhuriyeti***Qeveria –Vlada-Government- Hükümet***AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
MESLEKI EĞİTİM VE YETİŞKİMLER EĞİTİMİ AJANSI
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**No. 927/1
Tarih: 23.05.2025

Kosova Cumhuriyeti'nde Kamu Görevlileri Yasası No. 08/L-197'nin 80 ve 81. maddeleri, İlköğretim Yasası No. 04/L-032'nin 35. maddesi, İş Yasası No. 03/L-212'nin 8. maddesi, Mesleki Eğitim ve Öğretim Yasası No. 04/L-138'in 13. maddesi, 2024/19 sayılı Yönetmelik - ilk ve ortaöğretim düzeyindeki kamu eğitim ve öğretim kurumlarında (IEAA) müdür, müdür yardımcısı, öğretmen, profesyonel işbirlikçi, asistan, eğitmen ve sekreterlerin seçilmesi ve atanmasına ilişkin usul ve esaslara dair yönetmelik, 05/2012 sayılı İdari Talimat, 05/2015 sayılı İdari Talimat, 14/2014 sayılı İdari Talimat ve AAAPARr Ajansı'na dayanarak, şu duyuruda bulunur:

İŞ İLANI**PERSONEL ALIMINI İÇİN****Mesleki Eğitim ve Öğretim ile Yetişkin Eğitimi Ajansı****"11 Marsi" Prizren Yetkinlik Merkezi****Pozisyon Başlığı: Yetkinlik Merkezi Müdürü****Pozisyon Sayısı: Bir (1) pozisyon****Pozisyon Türü: Kamu Hizmeti Görevlisi****Sınıf/Katsayı: E 13 - 6.8****Atama Süresi: Dört (4) yıl, uzatma imkânı ile****Görevin temel sorumlulukları:**

IEAAP Müdürü, kurumun genel yönetimi ve idaresinde yürütme sorumluluğuna sahiptir; bu sorumluluklar şunları kapsar:

- Eğitim-öğretim kurumunun yıllık planının, gelişim planının ve yıllık faaliyet raporlarının hazırlanması;
- Eğitim yönetim bilgi sisteminin etkili ve verimli kullanımı ile ilgili uygulama kodlarına uyum, gerekli verilerin tüm eğitim yılı boyunca temin edilmesi ve güncellenmesi;
- Öğretmenlerin değerlendirilmesi, eğitim-öğretim kurumundaki disiplinin sağlanması ve öğretmenlerle diğer eğitim personeline ilişkin konuların yönetimi;
- Müfredatın uygulanmasının desteklenmesi ve denetlenmesi;
- Eğitim-öğretim kurumundaki öğretmen gruplarının ve profesyonel işbirlikçilerin çalışmalarının desteklenmesi ve denetlenmesi, ayrıca kurumun performans değerlendirmesi ve kalite yönetimi konusunda rol oynayan diğer mekanizmaların izlenmesi;
- Eğitim-öğretim kurumunun Yönetim Kurulu (KDSH), Veli Konseyi, Öğretmenler Kurulu, Öğrenci Konseyi ve kurum topluluğu ile iş birliği yapar;
- Yılda en az iki kez KDSH önünde rapor sunar;

- Mevcut mevzuata uygun olarak öğrencilere yönelik disiplin önlemlerinin uygulanması da dahil olmak üzere, eğitim-öğretim kurumunda çocuklar/öğrenciler için güvenli ve destekleyici bir ortam sağlar;
- Eğitim, Bilim, Teknoloji ve Yenilik Bakanlığı (MASHTI) tarafından öngörüldüğü şekilde belge ve veri arşivlemesini sağlar;
- Okul öncesi ve ilköğretim eğitimi ile ilgili yasa, MASHTI tarafından onaylanmış ikincil mevzuat ve eğitim yönetmeliğinden doğan yükümlülüklerle düzenlenen diğer konular;
- AAAPARr Ajansı müdürü tarafından belirlenen ve yasaya uygun olarak verilen diğer görevleri yerine getirir.

Adayların ilana başvurabilmeleri için karşılamaları gereken şartlar

- Kosova Cumhuriyeti vatandaşı olmak;
- Yürürlükteki mevzuata göre tam fiil ehliyetine sahip olmak;
- Dil Yasasına uygun olarak en az bir resmi dili bilmek;
- İlgili görevi yerine getirebilecek yeterlilikte olmak;
- Kasten işlenmiş bir suçtan dolayı hüküm giymemiş olmak;
- Kamu kurumunda ciddi bir disiplin ihlali nedeniyle yürürlükte olan bir disiplin cezasına sahip olmamak;
- Mesleki normatlara uygun olarak Yetkinlik Merkezleri için belirlenen şartları karşılayan üniversite eğitimine sahip olmak (başvurulan kurumun ilgili profile yönelik mesleki hazırlık);
- Eğitim alanında yönetme, yönetim veya idare konularında yüksek lisans derecesine sahip olmak (en az 300 AKTS, en az 5 yıllık üniversite eğitimi);
- Eğitim alanında yüksek lisans derecesine sahip olmak (300 AKTS/5 yıl üniversite eğitimi);
- Dört yıllık lisans derecesine sahip olmak (240 AKTS/4 yıl üniversite eğitimi);
- Öğretmenler için lisanslama talimatına göre geçerli öğretmenlik lisansına sahip olmak;
- Eğitimde yönetm, yönetim veya idare alanında profesyonel uygulama standartlarına dayalı olarak, MASHTI tarafından onaylanmış bir kamu kurumu tarafından sunulan bir mesleki niteliklendirme programını başarıyla tamamlamış olmak;
- IEAA-AP'de öğretmen olarak en az beş (5) yıl iş deneyimine sahip olmak;
- Yürürlükteki mevzuatla belirlenen kabul prosedürlerini başarıyla geçmek.

Başvuru anında adayların aşağıdaki belgelere sahip olmaları gerekmektedir:

- Madde 1.7, 1.8, 1.9 veya 1.10'a göre uygun yeterlilik düzeyine sahip tamamlanmış üniversite diploması;
- Kosova'daki okul müdürleri için mesleki uygulama standartlarına dayalı olarak, MASHTI tarafından onaylanmış bir kamu kurumu tarafından sunulan, eğitim alanında yönetm, idare veya yönetim konularında başarıyla tamamlanmış eğitim programı sertifikası;
- Eğer aday, eğitim alanında yönetm, idare veya yönetim konularında yüksek lisans programını tamamlamışsa, madde 1.12'ye göre eğitim yönetmeliği için eğitim sertifikası sunma zorunluluğu yoktur;
- Kimlik belgesinin (ID) fotokopisi;
- Sağlık durumunu belgeleyen, son altı ay içinde lisanslı bir sağlık kuruluşu tarafından verilmiş sağlık raporu;
- Sabuka kaydi/ adli sicil kaydi
- Kamu kurumunda ciddi bir disiplin ihlali nedeniyle yürürlükte olan bir disiplin cezasına sahip olmamak;
- Eğitim-öğretim sürecinde iş deneyimini kanıtlayan belge;
- Adayın son üç yıl içinde herhangi bir siyasi parti yapısında yönetm pozisyonunda

bulunmadığını beyan eden yeminli beyanname;

- 19/2024 sayılı Yönetmelikte yer alan formlara göre belirlenmiş kanıtlarla birlikte profesyonel portfolyo: okul müdürü, müdür yardımcısı, öğretmen, profesyonel işbirlikçi, asistan, eğitmen ve sekreterlerin seçim ve atama prosedürlerine ilişkin kurallar;
- Okul müdürlüğü pozisyonu için başvuran adaylar, okulun yönetsel kalitesini, öğretimi ve öğrenci başarılarını artırmayı hedefleyen yöntem ve stratejileri açıkça tanımlayan bir okul gelişim planı konsepti sunulmalıdır;
- Kosova dışında mezun olmuş adaylar, diplomalarını MASHTI tarafından denkliği sağlanmış şekilde sunulmalıdır;
- Bu maddede belirtilen başvuru belgeleri, kamu ilanında belirtilen süre içinde ve fiziki kopya olarak ilgili ofise teslim edilmelidir.

İlgili IEAA'nın gelişim planına erişim hakkında bilgilendirme

İlgili eğitim-öğretim kurumunun Gelişim Planı kavramının, profesyonel portfolyo hazırlığının önemli bir bölümü olduğunu göz önünde bulundurarak, kurumun Gelişim Planı "11 Marsi" Prizren Yetkinlik Merkezi'nden temin edilebilir.

Adayların değerlendirilmesi

- Adayların bilgi, beceri ve mesleki yeterliliklerinin değerlendirilmesi aşağıdaki yollarla yapılır:
- Yazılı sınav**, toplam değerlendirme puanının %50'sini oluşturur ve toplamda 100 puan üzerinden değerlendirilir;
- Sözlü mülakat**, genel değerlendirmenin %50'sini oluşturur: %30'u okulun gelişim planı konseptinin sunumu, %20'si ise profesyonel portfolyodur;
- Komisyon, bu Yönetmeliğe ait ilgili forma göre en az %70 toplam puan alan ve en yüksek puanı elde eden adayı nihai olarak seçer;
- Yazılı sınav ve sözlü mülakata çağrılacak kısa listeye alınan adaylar e-posta ve telefon yoluyla bilgilendirilecektir;
- Değerlendirmenin nihai sonuçları adaylara e-posta yoluyla bildirilecek, okulun duyuru panosunda ve <https://konkursi.rks-gov.net/> adresinde yayımlanacaktır.

Başvuru süresi ve yöntemi

Konkurs, yayımlandığı tarihten itibaren **24.05.2025** tarihinden **22.06.2025** tarihine kadar 30 takvim günü boyunca açık kalacaktır.

Başvuru belgeleri, Mesleki Eğitim ve Öğretim ile Yetişkin Eğitimi Ajansı'na (AAAPARr) teslim edilmelidir.

Adres: "Agim Ramadani" Caddesi, 10000 Prishtine, üçüncü kat, saat 09:00 - 15:00 arası. Başvuru formu AAAPARr idaresinden temin edilip aynı yerde teslim edilir.

Başvuru formunda açıkça başvuru pozisyonunun adı belirtilmeli ve başvuruya eklenen belgeler fotokopi olmalı, geri verilmez — noter tasdikli diplomalar hariç.

Doğru ve geçerli bilgi olarak yalnızca ilgili belgelerle kanıtlanmış bilgiler kabul edilir (başvuru formunda sadece beyan edilmiş olanlar değil).

Azınlık toplulukları ve üyeleri, engelli bireyler ve az temsil edilen cinsiyet grupları, yürürlükteki mevzuata uygun olarak adil ve orantılı temsil hakkına sahiptir.

Adaylar iki veya daha fazla pozisyona başvuruyorsa, her pozisyon için ayrı başvuru formu sunmaları gerekmektedir.

Açıklama/uyarı: Bu ilanda belirtilen resmi süre dışında teslim edilen başvurular, eksik belgeli başvurular ve başvuru formunun doğru ve açık şekilde doldurulmaması durumunda başvurular değerlendirmeye alınmayacaktır.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Br. 927/1
Datum: 23.05.2025

Na osnovu članova 80 i 81 Zakona o javnim službenicima br. 08/L-197, člana 35 Zakona br. 04/L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, člana 8 Zakona o radu br. 03/L-212, člana 13 Zakona o stručnom obrazovanju i osposobljavanju 04/L-138, Uredbe 19/2024 o postupcima za izbor i imenovanje direktora i zamjenika direktora, nastavnika, stručnih saradnika, asistenata, instruktora i sekretara u javnim obrazovnim i osposobljavajućim ustanovama JOOU (IEAA) preduniverzitetskog obrazovanja, Administrativnog uputstva 05/2012, Administrativnog uputstva 05/2015, Administrativnog uputstva 14/2014, Agencija za stručno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje odraslih ASOOOO (AAAPARr), ovim objavljuje sljedeće:

KONKURS
ZA POPUNJAVANJE RADNIH MJESTA

Agencija za stručno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje odraslih

Centar kompetencija “11 Mart” u Prizrenu

Naziv radnog mjesta: Direktor Centra za kompetencije
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija
Vrsta pozicije: Zaposlenik u javnoj službi
Klasa/Koeficijent: E 13-6.8
Trajanje imenovanja: Četiri (4) godine, s mogućnošću produženja

GLAVNE RADNE OBAVEZE:

Direktor JOOU (IEAAP)-a ima izvršnu odgovornost za cjelokupno upravljanje i administraciju institucije, uključujući:

- Pripremu godišnjeg plana, plana razvoja obrazovne ustanove i godišnjih izvještaja o radu;
- Efikasno i efektivno korištenje informacionog sistema za upravljanje obrazovanjem i pridržavanje srodnih kodeksa prakse, osiguravanje i ažuriranje potrebnih podataka tokom cijele školske godine;
- Evaluaciju nastavnika, disciplina u obrazovnoj ustanovi i druga pitanja vezana za nastavnike i druge obrazovne radnike;
- Podršku i nadzor nad implementacijom nastavnog plana i programa;
- Podržavanje i nadzor rada aktiva i stručnih saradnika obrazovne ustanove, kao i drugih mehanizama obrazovne ustanove koji imaju ulogu u procjeni učinka ustanove i upravljanju kvalitetom rada ustanove;
- Sarađuje s Upravnim vijećem obrazovne ustanove (UVŠ), Vijećem roditelja, Vijećem nastavnika, Vijećem učenika i zajednicom obrazovne ustanove.
- Izvještava UVŠ najmanje dva puta godišnje;
- Osigurava sigurno i podržavajuće okruženje za djecu/učenike u obrazovnoj ustanovi, uključujući primjenu disciplinskih mjera protiv učenika, u skladu s važećim zakonodavstvom;
- Čuvanje dokumenata i podataka, kako je propisano od strane Ministarstva obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacija (MONT);
- Druga pitanja regulisana zakonom o preduniverzitetskom obrazovanju, podzakonskim aktima koje je odobrio MONT i obavezama koje proizlaze iz propisa o obrazovanju.
- Obavlja i druge poslove koje mu dodijeli direktor Agencije za stručno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje odraslih ASOOOO (AAPARr), u skladu sa zakonom;

Uslovi koje kandidati moraju ispunjavati da bi učestvovali na konkursu

- 1.1. Biti državljanin Republike Kosovo;
- 1.2. Imati punu sposobnost djelovanja, u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- 1.3. Da tečno govori najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- 1.4. Biti u stanju izvršiti odgovarajući zadatak;
- 1.5. Da ne bude osuđivan za umišljajno počinjenje krivičnog djela;
- 1.6. U javnoj ustanovi ne bi trebalo biti na snazi disciplinskih mjera za ozbiljne prekršaje;
- 1.7. Imati završeno univerzitetsko obrazovanje, nivo kvalifikacija koji ispunjavaju uslove prema profesionalnim normama za Centre kompetencije (profesionalna priprema za relevantne profile institucije u kojoj se prijavljuju);
- 1.8. Master za rukovođenje, administraciju ili menadžment u obrazovanju (kvalifikacija od 300 ECTS bodova, najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- 1.9. Master obrazovanja (kvalifikacija od 300 ECTS bodova/5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- 1.10. Četverogodišnji Bachelor (kvalifikacija od 240 ECTS bodova/4 godine univerzitetskog obrazovanja);
- 1.11. Da posjeduje redovnu nastavničku licencu u skladu sa smjernicama za licenciranje nastavnika;
- 1.12. Uspješno završen program stručne kvalifikacije za rukovođenje, administraciju ili menadžment u obrazovanju, zasnovan na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, koje nudi javna institucija odobrena od strane MONT-a;
- 1.13. Imati najmanje pet (5) godina radnog iskustva kao nastavnik na ASOOOO (AAAPARr).
- 1.14. Da uspješno prođe procedure prijema propisane važećim zakonodavstvom.

U trenutku prijave, kandidati moraju posjedovati sljedeću dokumentaciju:

- Završena fakultetska diploma za odgovarajući nivo kvalifikacije prema tačkama 1.7, 1.8, 1.9 ili 1.10 ovog člana;
- Certifikat o uspješno završenom programu obuke za rukovođenje, administraciju ili menadžment u obrazovanju, zasnovanom na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, koji nudi javna institucija odobrena od strane MONT-a;
- Ako je kandidat završio Master studijski program iz oblasti rukovođenja, administracije ili menadžmenta u obrazovanju, nije dužan dostaviti dokaz/certifikat o obuci iz oblasti liderstva u obrazovanju u skladu sa tačkom 1.12. ovog člana;
- Kopija identifikacionog dokumenta (ID);
- Zdravstveno uvjerenje izdato u posljednjih šest mjeseci od strane licencirane zdravstvene ustanove, kojim se dokazuje zdravstveno stanje pacijenta;
- Dokaz da nije osuđivan/a za umišljajno počinjeno krivično djelo;
- Ne bi trebalo biti na snazi disciplinske mjere za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- Ovjera radnog iskustva u obrazovnom procesu;
- Izjava pod zakletvom kojom se potvrđuje da kandidat u posljednje tri godine nije obavljao nikakvu vodeću funkciju u strukturama političke stranke;
- Profesionalni portfolio sa dokazima prema uputama u obrascima Uredbe 19/2024 o

- postupcima za izbor i imenovanje direktora i zamjenika direktora, nastavnika, stručnih saradnika, asistenata, instruktora i sekretara u javnim obrazovnim i osposobljavajućim ustanovama (IEAA) preduniverzitetskog obrazovanja;
- Za pozicije direktora škole, kandidati podnose koncept plana razvoja škole, koji konkretno opisuje metodu i strategiju putem koje će se poboljšati upravljački kvalitet škole, nastava i rezultati učenika.
 - Kandidati koji su diplomirali izvan Kosova moraju imati diplome nostrificirane od strane MONT-a;
 - Dokumentacija za prijavu, kako je definirana u ovom članu, dostavlja se u štampanom obliku uredu i u roku navedenom u javnom oglasu.

Informacije o pristupu planu razvoja odgovarajuće IEAA

Znajući da je koncept Razvojnog plana odgovarajuće obrazovne ustanove jedan od Tačke za pripremu profesionalnog portfolija, Plan razvoja institucije, možete dobiti u Centru za kompetencije „11 Marsi“ u Prizrenu.

Evaluacija kandidata

- Procjena znanja, vještina i profesionalnih kvaliteta kandidata vrši se putem:
- Pismeni test**, koji čini 50% ukupne ocjene i ima ukupno 100 bodova,
- Usmeni intervju** čini 50% ukupne ocjene, 30% predstavljanje koncepta plana razvoja škole, a 20% profesionalni portfolio.
- Komisija vrši konačan izbor pobjedničkog kandidata sa najvećim brojem bodova, ali najmanje 70% od ukupnog broja bodova prema odgovarajućem obrascu ove Uredbe.
- Uži izbor kandidata pozvanih na pismeni test i usmeni intervju, kao i raspored intervjuva, bit će obaviješten putem e-pošte i telefona.
- Konačni rezultati evaluacije bit će poslani kandidatima putem e-pošte, objavljeni na oglasnoj tabli škole i na <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Rok i način prijave

Konkurs ostaje otvoren 30 kalendarskih dana od dana objavljivanja od datuma **24.05.2025** do datuma **22.06.2025**.

Podnošenje dokumenata se vrši u Agenciji za obrazovanje i stručno osposobljavanje i obrazovanje odraslih (AAAPARr). Adresa: Ulica „Agim Ramadani“ 10000, Priština, treći sprat, radno vrijeme od 09.00-15.00. Zahtjev je primljen i dostavljen administraciji AAAPARr-a.

U prijavi mora biti jasno naveden naziv radnog mjesta, a dokumenti priloženi uz prijavu moraju biti kopije i neće biti vraćeni, osim diploma ovjerenih kod notara.

Samo informacije koje su dokazane relevantnim dokumentima (ne samo navedene u prijavi) smatraju se tačnim i istinitim informacijama;

Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe s invaliditetom i nedovoljno zastupljeni spol imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost kako je određeno važećim zakonodavstvom.

Ako se kandidati prijavljuju za dva ili više radnih mjesta, kandidati moraju podnijeti odvojene prijave za svako radno mjesto.

Napomena: Sve nepotpune prijave, netačne i očigledne propuste u prijavnom obrascu, te one podnesene izvan službenog roka navedenog u ovom konkursu neće biti razmatrane.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Burektorja nShesh” SH.P.K. me seli në Gjilan, pronare Refa Shabani ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812004852 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Burektorja nShesh” D.O.O. Gnjlane, Refa Shabani donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812004852 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Burektorja nShesh” L.L.C. with headquarters Gjilan, Refa Shabani has come to the decision to quit its business: 812004852 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr.929/1
Datë: 23.05.2025

Bazuar në nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 08/L-197, nenin 35 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, nenin 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Rregulloren 19/2024 për procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Udhëzimit administrativ 05/2012, Udhëzimit administrativ 05/2015, Udhëzimit administrativ 14/2014, Agjencia e AAPARr-së, shpall këtë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Agjencia e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur

Qendra e Kompetencës “11 Marsi” në Prizren

Titulli i vendit të punës: Zëvendësudrejtor i Qendrës të Kompetencës

Numri i pozitive: Një (1) pozitë

Lloj pozitës: Nëpunës i shërbimit publik

Klasa/Koeficienti: E 14-6.7

Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet, me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore të punës :

Zëvendësdrejtor për marrëdhënie me biznese dhe sigurimin e të hyrave

- Zv. drejtori, është përgjegjës për marrëdhënie me biznes dhe sigurimin e të hyrave;
- Zv. drejtori i shkollës, është përgjegjës dhe garanton zhvillimin e aktiviteteve për gjenerimin e të ardhurave;
- Organizimin e trajnimeve për zhvillimin dhe aftësimin e të nxënësve dhe kandidatëve për tregun e punës përmes ofrimit të kurseve afatshkurtra dhe afatgjata;
- Organizimin e panaireve për prezantimin dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të Qendrave të Kompetencës;
- Dhënen me qira të hapësirave me pajisjet e nevojshme për bizneset private;
- Mbështetje në ofrimin e shërbimeve këshilluese për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta dhe nxënësit e QK përkatëse;
- Bashkëpunon ngushtë me kompanitë private dhe publike;
- Siguron mundësinë e aftësimit të nxënësve në organizata të ndryshme private dhe publike brenda dhe jashtë vendit për të mundësuar punësimin e të diplomuarve dhe kandidatëve;
- Siguron trajnime dhe aftësim të vazhdueshme që përshtaten me nevojat e tregut të punës;
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendës drejtorin për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare dhe në rast të mungesës së drejtorit, e zëvendëson atë;
- Zv. drejtori i shkollës, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, përdor në mënyrë efektive dhe efikase burimet e disponueshme financiare dhe asetet për të përmirësuar rezultatet e të nxënët;
- Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori/ësja e agjencisë së AAPARr-së, në pajtim me ligjin.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.3. Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 1.6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucionin publik;
- 1.7. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për Qendrat e Kompetencës (përgatitje profesionale për profile përkatëse të institucionit ku konkurron);
